



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GRAMSH  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 4293/2 Prot

Gramsh, më 17.11.2021

**VENDIM**

Nr. 117 datë 17.11.2021

“Për

**Autorizim për përfaqësimin e Bashkisë Gramsh si Aksionar në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë “ECO ELB” SH.A**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 8, pika 2 dhe nenit 54, pika “k” të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 140 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, si dhe nenit 14/1 të Statutit të Shoqërisë Tregtare të përbashkët “Trajtim Mbetjesh Elbasan” sh.a, Këshilli i Bashkisë Gramsh, si organi përfaqësues i personit juridik publik-Bashkia Gramsh, në cilësinë e aksionarit të shoqërisë “ECO ELB” sh.a, në mbledhjen e tij të datës \_\_.11.2021, pasi mori në shqyrtim propozimin e Kryetarit të Bashkisë Gramsh,

**VENDOSI:**

1. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Gramsh, z. Klodian Taçe, të përfaqësojë Bashkinë Gramsh si aksionar të shoqërisë “ECO ELB” sh.a, në të gjitha mbledhjet që do të zhvillojë Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë “ECO ELB” sh.a, gjatë gjithë periudhës së mandatit të Këshillit të Bashkisë Gramsh.

2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Gramsh për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLI I BASHKISË GRAMSH

KRYETAR  
Gréta LENA

Konc.Dakt: Xh.Gjini  
Pranoi: G.Lena  
Miratoi: G.Lena  
Dosja \_\_\_\_\_